



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15178 Prot.

Lezhë, më 29 . 9 . 2023

VENDIM

Nr. 37, Datë 28. 09. 2023

**PËR
MOSDHËNIEN E MANDATIT SI ANËTARE E KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË
ZNJ. FLORA MARGJONAJ**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 49, neni 54 dhe neni 55, si dhe të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 758, datë 04.09.2023 “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumëëmërore e Partisë Socialdemokrate, znj. Flora Pjetër Margjonaj”, përcjellë me shkresën me nr.prot 6799, datë 08.09.2023 “Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit”, me propozim të Komisionit të Mandateve, Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

Vendosi :

1. Mosdhënien e mandatit si anëtare e Këshillit të Bashkisë Lezhë znj. Flora Margjonaj, bazuar në deklaratën noteriale nr. rep. 3403 dhe nr. kol. 2164, datë 26.09.2023, me anë të së cilës refuzon marrjen e mandatit si anëtare e Këshillit të Bashkisë Lezhë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI
NDUE LULI**



Nr. 15178/1 prot
dt. 3.10.2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 775/8 Prot.

Lezhë, më 02 . 10 .2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16, pika 2, germa "b" të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", nenin 49 pika 4, germa "b", nenin 54 germa "j" si dhe nenin 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.37, datë 28.09.2023, të këshillit të bashkisë Lezhë "Për mosdhënien e mandatit si anatare e këshillit të bashkisë Lezhë znj.Flora Margjonaj".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

